



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Datë/a:	14.05.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	“AMC Corporation SH.P.K” – Besfort Berisha
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike. <i>Liridona Kastrati</i> Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga “AMC Corporation SH.P.K” me përfaqësues Besfort Berisha me të cilën kërkohet që me datë 21, 22 dhe 23 Maj 2021 nga ora 10:00 deri në 21:30 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike në sheshin “Zahir Pajaziti”, aktivitet ky që do të zhvillohet në kuadër të javës së shëndetit mendor.

Në shesh do të vendoset një automjet sprinter nga i cili do të lëshohet muzikë me DJ dhe do të vendosen disa tavolina (shankerica) të cilat do të përdoren për ti vendosur disa dhurata të cilat do të shpërndahen dhe një ekran LED.

Hapësira e kërkuar do të jetë 12m x 10m dhe do të vendosen disa litar për të kufizuar hapësirë dhe për të ruajtur distancën.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Zahir Pajaziri” me datë 21, 22 dhe 23 Maj 2021 nga ora 10:00 deri në 21:30 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.